



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 21, Datë 22.02.2012

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila jani Kryetare
- Z. Gerdjan Xhanari Nënkyetar
- Znj. Marsida Xhaferllari Anëtare
- Z. Zamir Mocka (Stefani) Anëtar
- Z. Altin Goxhaj Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2012, ka vazhduar trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje sh.a, duke shqyrtuar përgjigjen e këtij operatori me shkresë nr. prot. 46/1, datë 16.02.2012, ndaj kërkesës për informacion të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, drejtuar këtij operatori me shkresën nr. prot 46, datë 31.01.2011, në lidhje me kërkesën për informacion për ankesat e konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje sh.a.

Komisioni pas shqyrtimit të shkresës së sipërpërmendur,

VËREN SE:

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje sh.a, ka filluar në mbledhjen e datës 14 gusht 2011 dhe për një procedim të mëtejshëm të çështjes Komisioni me shkresë nr prot 25/1, datë 10.08.2011, i ka kërkuar operatorit CEZ Shpërndarje sh.a informacion të detajuar, të argumentuar dhe të verifikueshëm, me evidencat përkatëse, sipas problematikave të listuara në këto shkresë, për një periudhë 1 vjeçare si dhe vënien në dispozicion të listave të plota, të të gjithë abonentëve, që kanë pasur problematikat e sipërpërmendura.

Komisioni, me shkresë nr. prot 25/3, datë 14.11.2011 i bën me dije operatorit CEZ Shpërndarje sh.a marrjen e Vendimit nr.17, datë 07.11.2011, nëpërmjet të cilit CEZ Shpërndarje gjohet me shumën prej 300,000 leke, për mosdhënie të informacionit të plotë sipas nenit 52/1 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Komisioni konstaton se në vijim të Vendimit nr. 17, CEZ shpërndarje-s i është rikërkuar informacioni i munguar me shkresë nr. Prot 46, datë 31.01.2012, duke i bërë me dije se

mosdhënia e informacionit sipas kërkesës së Komisionit përben shkelje të përsëritur administrative sipas pikës 4 të nenit 57 të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Komisioni shqyrtoi përgjigjen e CEZ shpërndarje sh.a drejtuar Komisionit me shkresë nr prot 602/1, datë 10.02.2012, në mbledhjen e datës 22.02.2012, ku u konstatua se përsëri mungon informacioni i detajuar, i argumentuar dhe i verifikueshëm, me evidencat përkatëse si dhe listat e plota e të gjithë abonentëve, që kanë pasur ndërprerje të furnizimit me energji elektrike, të konsumatorëve të gjobitur, të konsumatorëve që janë faturuar aforfe (1000 kwore/muaj), të konsumatorëve, të cilët janë faturuar me zërin “vlëra e debisë” si dhe të gjitha evidencat përkatëse në lidhje me ndryshimin e vendndodhjes së sporteve dhe informimin e konsumatorëve, për një periudhë 1 vjeçare (korrik 2010-korrik 2011).

Komisioni konstaton se, në vijim të Vendimit nr.17, datë 07.11.2011, shkresës së Komisionit drejtuar CEZ me nr. prot 46, datë 31.01.2012 dhe përgjigjes së CEZ me shkresë nr prot 602/1, datë 10.02.2012, operatori CEZ Shpërndarje sh.a, ka kryer shkelje të përsëritur të nenit 52/1 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, sipas të cilit:

“Tregtarët janë të detyruar të japin në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji”.

Sipas pikës 4 të nenit 57 të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve:

“Në rast përsëritje, gjobat e parashikuara në këtë nen dyfishohen. Përsëritje vlerësohet rasti, kur shkelësi kryen të njëjtën shkelje për herë të dytë, brenda një periudhe prej 5 vjetësh”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 52/1; shkronjën “d”, pika 2, neni 57; pikën 4 të nenit 57 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “c”, pika 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”.

VENDOSI:

1. Operatori CEZ Shpërndarje sh.a, të gjobitet në masën 600 000 leke.
2. Operatori CEZ Shpërndarje të njoftojë menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETARI KOMISIONIT

